

UDHËZIM
Nr.2310, datë 16.12.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.2365, DATË 26.11.2008 MBI ZBATIMIN E
VENDIMIT NR.277, DATË 18.6.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe në bazë të pikës 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr.2365, datë 26.11.2008 “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 “Për përfitimin nga statusi i të verbërve””, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

1. Në pikën 3 të udhëzimit, fjalia e fundit: “Kujdestari duhet të pajiset me raport mjekësor, i cili duhet të përsëritet çdo vit”, ndryshohet si më poshtë:

...“Mjeku i familjes do të vërtetojë me raport mjekësor të përvitshëm, kujdestarinë e të verbrit, si person të aftë nga gjendja shëndetësore.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE
SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera